



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr.68/4 prot.

Tiranë më 26.01.2023

URDHËR

Nr.12, datë 26.01.2023

PËR KONTROLLUESIN “CANADIAN KINDERGARTEN TIRANA – KJL&CO”

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Canadian Kindergarten Tirana – KJL&CO”.

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 07, datë 09.01.2023 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit “Canadian Kindergarten Tirana – KJL&CO” (në vijim, “Kontrolluesi”), me objekt:

- Verifikimi i një ankese të paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit, pasi shqyrtoi procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ pranë Kontrolluesit, ka konstatuar se:

Kontrolluesi është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ushtron aktivitet në fushën e edukimit parashkollor privat, çerdhe, kopsht gjithashtu dhe aktivitete në fushën e mësimdhënies dhe edukimit.

Pranë Zyrës së Komisionerit është paraqitur ankesa e subjektit E.H. nëpërmjet të cilës pretendon se në llogaritë e krijuara dhe të administruara në rrjetet sociale (*Facebook dhe*

Instagram) nga Kontrolluesi, publikohen fotografi të fëmijëve të mitur, të regjistruar pranë këtij institucioni. Gjithashtu ankuesja pretendon se, për publikimin e fotografive në rrjetet sociale të Kontrolluesit, nuk është siguruar pëlqimi paraprak i prindërve në cilësinë e kujdestarit ligjor të fëmijës.

Nga verifikimet online, konstatohet se Kontrolluesi "*Canadian Kindergarden Tirana*" disponon dy llogari në rrjetet sociale (*Facebook dhe Instagram*). Në këto llogari, Kontrolluesi publikon, ndër të tjera, fotografi të aktiviteteve me fëmijët, të zhvilluara gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Nga verifikimet e kryera nga grupi i kontrollit, rezulton se, Kontrolluesi disponon një "*Kontratë shërbimi Çerdhe dhe Kopsht*" objekt i së cilës është, ndër të tjera, rregullimi i marrëdhënies dhe kushteve të ofrimit të shërbimit midis kopshtit dhe prindit, për fëmijën. Nga verifikimi i kontratës, konstatohet se Kontrolluesi nuk realizon detyrimin për informim përkundrejt prindërve, për publikimin e fotografive të fëmijëve në rrjetet sociale "*Facebook*", "*Instagram*", etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të ligjit.

Gjithashtu, kontrolluesi nuk aplikon dispozita/mekanizma lidhur me dhënien e pëlqimit nga ana e prindërve, për publikimin e fotove të fëmijëve në rrjetet sociale, në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe kriteret ligjore të përpunimit të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të ligjit dhe Udhëzimit nr. 4, datë 16.03.2010 të Komisionerit "*Për marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në sektorin e arsimit*".

Pika 1 e nenit 3 të ligjit parashikon se, "*E dhënë personale është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.*"

Gjithashtu pika 12 e po këtij neni parashikon se, "*Përpunim i të dhënave personale është çdo veprim ose grup veprimesh, të cilat janë kryer mbi të dhënat personale, me mjete automatike ose jo, të tilla si mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, shfrytëzimi, transmetimi, shpërndarja ose ndryshe duke vënë në dispozicion, shtrirja ose kombinimi, fotografimi, pasqyrimi, hedhja, plotësimi, seleksionimi, bllokimi, asgjësimi ose shkatërrimi, edhe në qoftë se nuk janë të regjistruara në një bankë të dhënash.*"

Lidhur me sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, publikimi i të dhënave personale të fëmijëve të mitur (*fotografi dhe video*), në llogaritë e krijuara dhe të administruara në rrjetet sociale (*Facebook, Instagram, etj.*), pa siguruar pëlqimin paraprak të prindërve dhe/ose të kujdestarëve ligjor, nuk gjen mbështetje në asnjë parashikim ligjor konkret me qëllim që të konsiderohet i ligjshëm. Kontrolluesi ka detyrimin që të përpunojë të dhënat personale të subjekteve të të dhënave duke respektuar parimin e ligjshmërisë së përpunimit dhe në përputhje me kriteret ligjore të përpunimit, parashikuar në nenet 5 dhe 6 të Ligjit.

Kur Kontrolluesi fillon një përpunim të dhënash, ai duhet të konsiderojë se cila është baza e përshtatshme ligjore për vazhdimin e përpunimit, në përputhje me kriteret e parashikuara në

pikën 1 të nenit 6 të ligjit. Në rast se përpunimi i të dhënave mbështetet në sigurimin paraprak të “pëlqimit”, Kontrolluesi duhet të mundësojë një mekanizëm, në mënyrë që “pëlqimi” të jetë në formë të shkruar, ku shfaqet vullneti i plotë dhe i lirë i subjektit të të dhënave, i cili është në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen. Nëse është marrë në përpunim me parashikimet ligjore, “pëlqimi” është një mjet i cili i mundëson subjektit të të dhënave kontroll nëse të dhënat personale të tij do të përpunohen apo jo.

Është e rëndësishme të theksohet se përpara se të kërkohet *pëlqimi*, nga Kontrolluesi duhet përmbushur detyrimi për informim, sipas përcaktimeve të nenit 18 të Ligjit, i cili parashikon se, Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet ta informojë subjektin e këtyre të dhënave. Në këtë informacion duhet të përcaktohen kategoritë e të dhënave personale, që do të përpunohen, qëllimi i përpunimit, emri, adresa e kontrolluesit si dhe çdo informacion tjetër i nevojshëm për të garantuar përpunimin e drejtë të të dhënave personale.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vënë në dispozicion Kontrolluesit.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesja e Kontrolluesit është paraqitur në seancën dëgjimore datë 19.01.2023, të organizuar nga Zyra e Komisionerit. Gjatë seancës nuk pati kundërshtime për konstatimet e Zyrës së Komisionerit nga përfaqësuesja e Kontrolluesit duke deklaruar angazhimin mbi marrjen e masave për recuperimin e shkeljeve të konstatuara.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 18, 29, 30 pika 1, germa “b” dhe 32, pika 1 të Ligjit,

URDHËROJ :

1. Kontrolluesi të realizojë fshirjen e të dhënave personale fotografi/video të të gjithë fëmijëve, në cilësinë e subjekteve të të dhënave, të publikuara në rrjetet sociale “Facebook”, “Instagram”, në të gjitha ato raste që nga ana e Kontrolluesit nuk është garantuar marrja e pëlqimit nga prindërit e fëmijëve të të miturve ose përfaqësuesit ligjor të tyre.
2. Kontrolluesi, të marrë masa për përpunimin e të dhënave personale në përpunim me parimet dhe kriteret ligjore të sanksionuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit;
3. Kontrolluesi, të marrë masa për zbatimin e detyrimeve, në lidhje me informimin e plotë të subjekteve të të dhënave dhe marrjen e pëlqimit sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit;

4. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - (i) brenda 7 (shtatë) ditëve, detyrimet e treguara në pikën 1 më sipër;
 - (ii) vazhdimisht, detyrimet e treguara në pikat 2 dhe 3 më sipër;
5. Kontrolluesi mbart detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit, lidhur me zbatimin e detyrës së lënë sipas pikës 1 në këtë Urdhër, brenda 30 ditëve.
6. Afati i sipërpërmendur, fillon nga data e marrjes dijeni të këtij akti.
7. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Urdhrave të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative.

Ky Urdhër u shpall sot më datë 26.01.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi